VENDIM
Nr. 208, datë 24.7.2026

MBI MIRATIMIN E DISA SHTESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË KONTRATËN "PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI (KESH SHA), DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SHA, PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË FURNIZOHEN NGA FSHU SHA"

Në zbatim të neneve 16, 20, germa "h", 49, 61 germa "f", 70, 135 pika 4 dhe 136 pika 2, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike"; pjesës I, nenit 5, pika 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.7.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2202 prot., datë 22.7.2026, "Mbi disa shtesa dhe ndryshime në kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a., dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 95, datë 20.5.2024, ka miratuar kontratën tip "Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.", e ndryshuar me vendimin nr. 133, datë 7.7.2025.

1. Kërkesa për rishikimin e kontratës tip

- ERE, me shkresën nr. 1886 prot., datë 16.6.2026, ka kërkuar informacion mbi lidhjen dhe ecurinë e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për periudhën 1.1.2026–31.12.2026.

- Me shkresën e përbashkët nr. 3016 prot., datë 1.7.2026, të KESH sh.a. dhe nr. 4280/2 prot., datë 1.7.2026, të FSHU sh.a., protokolluar në ERE me nr. 1886/1 prot., datë 6.7.2026, palët kanë depozituar për miratim kontratën e nënshkruar për shitblerjen e energjisë elektrike për vitin 2026.

- Palët kanë propozuar disa shtesa dhe ndryshime në kontratën tip të miratuar me vendimin nr. 95, datë 20.5.2024, të ndryshuar me vendimin nr. 133, datë 7.7.2025.

2. Përmbajtja e ndryshimeve të propozuara

Riformulime dhe saktësime në tekst

- Në nenin 9, pika 2, germa "b", propozohet që pagesa e faturave sistemuese të lidhet me datën e lëshimit të faturës dhe jo me datën e livrimit të energjisë elektrike. Konkretisht në fund të saj të shënohet: "Pagesa e faturave sistemuese mes palëve do të bëhet brenda 45 ditëve nga dita e lëshimit të faturës".

- Në nenin 14, pika 1, saktësohet se fatura përkatëse do të lëshohet jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike. Konkretisht "faturimi dhe pagesa" propozohet

të saktësohet: “Fatura përkatëse do të lëshohet jo më vone se data 10 e muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike”.

- Në nenin 14, pika 2, unifikohet afati i pagesës prej 45 ditësh nga data e lëshimit të faturës tatimore, si për faturat kryesore ashtu edhe për faturat sistemuese. Konkretisht paragrafi ndryshon dhe bëhet: “Pagesa e faturave do të bëhet brenda 45 ditëve nga data e lëshimit të faturës tatimore. Afati i pagesës së faturave sistemuese do të jetë i njëjtë me faturën për të cilën bëhet sistemimi.”.

Shtesa në kontratë

- Në nenin 3 “Përkufizime”, është propozuar shtimi i pikës 16.1 “data e maturimit të faturës” me përmbajtje: është data e fundit e periudhës së pagesës së faturës.

- Në nenin 14 është propozuar shtimi i pikës 3, të parë të “pagesës”, palët kanë dakordësuar të shtojnë pikën 3 me përcaktimet si më poshtë:

“Ndryshimi i datës së maturimit të faturës: Për raste të veçanta, me kërkesë zyrtare të arsyetuar të blerësit, paraqitur jo me vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara datës së maturimit të faturës përkatëse, shitësi mund të bie dakord për ndryshimin e datës së maturimit të asaj fature. Kërkesa dhe miratimi i shtyrjes se afatit të pagesës së faturës do të bëhet sipas formularit të aneksit 3 të kësaj kontrate. Me miratimin e kërkesës, palët përcaktojnë datën e re të maturimit.

Ndryshimi i datës së maturimit konsiderohet si data e detyrimit të pagesës për faturën përkatëse dhe deri në këtë datë, pagesa nuk konsiderohet e vonuar.

Pas skadimit të afatit të ri të maturimit, çdo pagesë e papaguar konsiderohet e vonuar dhe i nënshtrohet automatikisht interesave të vonesës dhe mjeteve ligjore të parashikuara në këtë kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

Palët justifikojnë vendosjen e kësaj dispozite të re me argumentin se: Ky parashikim është bërë për raste të veçanta në kushtet e vështirësive të mundshme financiare të blerësit. Në funksion të këtij parashikimi është shtuar aneksi 3 “Formular për kërkesë dhe miratim të shtyrjes së afatit të pagesës”.

Vlerësojmë se ERE, si organi që monitoron zbatimin e kontratave ndërmjet të licencuarve dhe përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik, duhet të ketë dijeni për çdo rast kur blerësi i ngarkuar me këtë detyrim (FSHU) has vështirësi likuiditeti që e detyrojnë të kërkojë shtyrje pagese, pasi kjo kontratë nuk është një marrëveshje tregtare e zakonshme, por instrumenti konkret nëpërmjet të cilit zbatohet detyrimi i shërbimit publik i vendosur nga shteti; një përsëritje apo përkeqësim i këtyre rasteve prek drejtpërdrejt qëndrueshmërinë financiare të vetë modelit të detyrimit të shërbimit publik, jo vetëm marrëdhënien dypalëshe të palëve. Për këtë arsye, vlerësojmë se neni duhet të riformulohet në mënyrë që blerësi, njëkohësisht me paraqitjen e kërkesës për shtyrje pranë shitësit, të njoftojë brenda të njëjtit afat edhe ERE-n, duke na siguruar informacionin e nevojshëm për ushtrimin e funksionit të saj monitorues.

Për raste të veçanta, me kërkesë zyrtare të arsyetuar të blerësit, paraqitur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara datës së maturimit të faturës përkatëse, shitësi mund të bie dakord për ndryshimin e datës së maturimit të asaj fature. Për këtë qëllim, blerësi, në të njëjtin afat prej 5 (pesë) ditësh pune, njofton njëkohësisht edhe Entin Rregullator të Energjisë (ERE). Kërkesa dhe miratimi i shtyrjes së afatit të pagesës së faturës do të bëhet sipas formularit të aneksit 3 të kësaj kontrate. Me miratimin e kërkesës, palët përcaktojnë datën e re të maturimit. Ndryshimi i datës së maturimit nuk mund të kalojë një periudhë më të gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data fillestare e maturimit. Data e re e maturimit konsiderohet si data e detyrimit të pagesës për faturën përkatëse dhe deri në këtë datë, pagesa nuk konsiderohet e vonuar. Pas skadimit të afatit të ri të maturimit, çdo pagesë e papaguar konsiderohet e vonuar dhe i nënshtrohet automatikisht interesave të vonesës dhe mjeteve ligjore të parashikuara në këtë kontratë dhe në legjislacionin në fuqi.”.

- Propozohet shtimi i aneksit III “Formular për kërkesë dhe miratim të shtyrjes së afatit të pagesës”, i cili operacionalizon procedurën e parashikuar në nenin 14.

3. Përditësimi i bazës ligjore

- Në kontratën e nënshkruar për vitin 2026, janë reflektuar saktësimet teknike në përputhje me fazën e katërt të hapjes së tregut, sipas urdhrit nr. 322, datë 30.12.2024, të ministrit përgjegjës për energjinë.

- Në bazën ligjore të kontratës është shtuar referenca ndaj vendimit nr. 1212/1 prot., datë 19.2.2026, të ministrit përgjegjës për energjinë, për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për furnizimin e FSHU sh.a. gjatë vitit 2026.

- Gjatë shqyrtimit të kontratës u konstatua se referencat ndaj ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, duhet të zëvendësohen me referencat përkatëse të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i cili ka hyrë në fuqi më 15.7.2026. Për këtë arsye, KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të depozitojnë kontratën me bazën ligjore të përditësuar sipas ligjit të ri, pasi vlerësojmë se dispozitat kalimtare të po këtij ligji (neni 135, pika 4, dhe neni 136, pika 2) parashikojnë se: aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 43/2015 (pra VKM-ja nr. 456/2022, dhe në vijim të saj kontrata tip e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 95/2024, ndryshuar me vendimin nr. 133/2025) vazhdojnë të zbatohen, për aq sa nuk bien ndesh me ligjin e ri, derisa të nxirren aktet e reja nënligjore sipas ligjit të ri, të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve në treg vazhdojnë të përmbushen deri në hyrjen në fuqi të akteve të reja.

- Konkretisht vlerësojmë se:

- “Bazë ligjore”, rreshti i parë (f. 1) “Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neni 20 germa “h”);” duhet të zëvendësohet me: “Ligjit nr. 59/2026 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neni 20, germa “h”, neni 135, pika 4, dhe neni 136, pika 2”.

- “Në kushtet kur:”, pika e parë (f. 2)”...në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, referenca duhet zëvendësuar me “...në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 106, nenit 135, pika 4, dhe nenit 136, pika 2, të ligjit nr. 59, datë 18.6.2026, “Për sektorin e energjisë elektrike.”.

- Neni 8, pika 1, “Përkufizimi i Forcës Madhore”...siç përcaktohet në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar...” zëvendësohet me “...ligjin nr. 59/2026, neni 3, pika 25, neni 135, pika 4, dhe neni 136, pika 2”.

4. Konsultimi publik

- Në zbatim të: Rregullores për procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga ERE:, kontrata është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s në rubrikën “Konsultime” më datë 8.7.2026 dhe nuk rezulton të jenë paraqitur komente apo sugjerime nga palë të treta.

5. Vlerësimi i ERE-s

- Kontrata e depozituar nga KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për vitin 2026 mbështetet në kontratën tip të miratuar nga Bordi i ERE-s dhe përbën aktin operativ që rregullon marrëdhëniet ndërmjet palëve për periudhën 1.1.2026–31.12.2026, në përputhje me pikën 4, të nenit 5, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, të ndryshuar.

- Neni 5, pika 4, i VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, i ndryshuar, parashikon se ndërmjet FSHU sh.a. dhe shoqërisë publike të prodhimit “negociohet kontrata, e cila miratohet nga ERE dhe nënshkruhet nga palët”, pa e cilësuar atë si “kontratë tip”. Kontrata tip, miratuar me vendimin nr. 95, datë 20.5.2024, ndryshuar me vendimin nr. 133, datë 7.7.2025, përbën aktin rregullator-model mbi bazën e të cilit negociohet e nënshkruhet kontrata konkrete e parashikuar nga dispozita e sipërcituar. Rrjedhimisht, kontrata e nënshkruar nga KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për periudhën

1.1.2026–31.12.2026 përbën vetë “kontratën” sipas nenit 5, pika 4, të VKM-së nr. 456/2022, e jo kontratën tip, term që mbetet i rezervuar për aktin e miratuar me vendimet nr. 95/2024 dhe nr. 133/2025, në përputhje edhe me dispozitat kalimtare të neneve 135, pika 4, dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026. Për sa më sipër, vlerësojmë se togfjalëshi “Kontratë tip” duhet zëvendësuar me “Kontrata” kudo në tekstin e kontratës konkrete.

- Për sa më sipër, vlerësohet të miratohen shtesat dhe ndryshimet e propozuara në kontratën tip, ndërsa KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të përditësojnë referencat ligjore në përputhje me nenet 20, germa “h”, 135 pika 4 dhe 136, pika 2, e ligjit nr. 59/2026 dhe të depozitojnë pranë ERE-s kontratën e nënshkruar me ndryshimet e reflektuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet e propozuara në kontratën “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a, për periudhën 1.1.2026–31.12.2026, lidhur në zbatim të kontratës tip, miratuar me vendimin nr. 95, datë 20.5.2024, ndryshuar me vendimin nr. 133, datë 7.7.2025, duke përfshirë shtimin e aneksit III “Formular për kërkesë dhe miratim të shtyrjes së afatit të pagesës” (tabela bashkëlidhur).

2. Shoqëria e Prodhimit të Energjisë Elektrike, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., të zëvendësojë kudo në tekst referencën e ligjit nr. 43/2025 me referencën ligjore të ligjit nr. 59/2026, si dhe të zëvendësojnë kudo në tekstin e kontratës togfjalëshin “Kontratë tip” me “Kontrata” (tabela bashkëlidhur).

3. Kontrata e nënshkruar nga palët me ndryshimet sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të dërgohet në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë KESH sh.a., FSHU sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petraq Lika

SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI (KESH SHA) DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SHA, PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË

FURNIZOHEN NGA FSHU SHA, PËR PERIUDHËN 1.1.2026–31.12.2026, LIDHUR NË ZBATIM TË KONTRATËS TIP, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 95, DATË 20.5.2024, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 133, DATË 7.7.2025, DUKE PËRFSHIRË SHTIMIN E ANEKSIT III "FORMULAR PËR KËRKESË DHE MIRATIM TË SHTYRJES SË AFATIT TË PAGESËS"

Lloji	Vendndodhja	Ishte	Bëhet
Ndryshon dhe bëhet	Kudo në tekstin e kontratës togfjalëshi "Kontratë tip" zëvendësohet me "kontrata"	Togfjalëshi "Kontratë tip" .	Togfjalëshi "Kontrata".
Ndryshon dhe bëhet	Baza ligjore, rreshti i parë	"*Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, neni 20 germa "h"*	"Ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 20, germa "h", neni 135, pika 4, dhe neni 136, pika 2".
Ndryshon dhe bëhet	Në kushtet kur	"...në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, referenca"	"...në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 106, nenit 135, pika 4, dhe nenit 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike.".
Ndryshon dhe bëhet	Neni 8, pika 1, "Përkufizimi i Forcës Madhore"	"...siç përcaktohet në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar".	"...siç përcaktohet në Ligjin nr. 59/2026, neni 3, pika 25, neni 135, pika 4, dhe neni 136, pika 2.".
Shtesë	Neni 3, Përkufizimet (pika e re 16.1)	(nuk ekziston në kontratën tip të miratuar me vendimin nr. 95/2024, të ndryshuar me vendimin nr. 133/2025)	Shtohet pika 16.1: "Data e maturimit të faturës", është data e fundit e periudhës së pagesës së faturës.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 9, pika 2, germa "b" (fjalia e fundit)	"Pagesat sipas faturave sistemuese mes palëve do të bëhen brenda 45 ditëve nga dita e fundit e livrimit për muajin përkatës.".	"Pagesa e faturave sistemuese mes palëve do të bëhet brenda 45 ditëve nga dita e lëshimit të faturës.".
Ndryshon dhe bëhet	Neni 14, pika 1 (paragrafi i fundit)	"Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike.".	"Fatura përkatëse do të lëshohet jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike.".
Ndryshon dhe bëhet	Neni 14, "Pagesa" (paragrafi kryesor)	"Pagesa e faturës principale do të bëhet brenda 45 ditëve nga data e lëshimit të faturës tatimore. Për faturat sistemuese, data e pagesës do të jetë e njëjtë me faturën principale për të cilën bëhet sistemimi.".	"Pagesa e faturave do të bëhet brenda 45 ditëve nga data e lëshimit të faturës tatimore. Afati i pagesës së faturave sistemuese do të jetë i njëjtë me faturën për të cilën bëhet sistemimi.".
Shtohet	Neni 14 (pikë e re 3) dhe aneksi 3 i ri	(nuk ekziston në kontratën tip)	Shtohet pika 3: "Ndryshimi i datës së maturimit të faturës: Për raste të veçanta, me kërkesë zyrtare të arsyetuar të blerësit, paraqitur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara datës së maturimit të faturës përkatëse, shitësi mund të bie dakord për ndryshimin e datës së maturimit të asaj fature. Për këtë qëllim, blerësi, në të njëjtin afat prej 5 (pesë)

			ditësh pune, njofton njëkohësisht edhe Entin Rregullator të Energjisë (ERE). Kërkesa dhe miratimi i shtyrjes së afatit të pagesës së faturës do të bëhet sipas formularit të aneksit 3 të kësaj kontrate. Me miratimin e kërkesës, palët përcaktojnë datën e re të maturimit. Ndryshimi i datës së maturimit nuk mund të kalojë një periudhë më të gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data fillestare e maturimit. Data e re e maturimit konsiderohet si data e detyrimit të pagesës për faturën përkatëse dhe deri në këtë datë, pagesa nuk konsiderohet e vonuar. Pas skadimit të afatit të ri të maturimit, çdo pagesë e papaguar konsiderohet e vonuar dhe i nënshtrohet automatikisht interesave të vonesës dhe mjeteve ligjore të parashikuara në këtë kontratë dhe në legjislacionin në fuqi.”.

Shtohet: Aneksi III

“ANEKS III

FORMULAR PËR KËRKESË DHE MIRATIM TË SHTYRJES SË AFATIT TË PAGESËS

Referuar kontratës nr... ., datë ... ndërmjet:
Shitësi: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.
dhe
Blerësi: Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.
Blerësi paraqet kërkesë për shtyrjen e afatit të pagesës për faturën e mëposhtme:
1. Numri i faturës: …….
2. Data e faturës: ……...
3. Vlera e faturës: ……
4. Data aktuale e maturimit: ……
5. Data e re e kërkuar e maturimit: …….
6. Arsyeja kërkesës për
[Përshkrimi i detajuar i rrethanave dhe dokumentacionit mbështetës]
Blerësi deklaron se informacioni i mësipërm është i saktë dhe se kërkesa paraqitet në përputhje me kontratën.
Palët bien dakord që data e re e maturimit për faturën e sipërpërmendur të jetë .....
Për qëllime të kontratës dhe të ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, data e mësipërme do të konsiderohet data e re e maturimit të detyrimit dhe pagesa nuk do të konsiderohet e vonuar përpara skadimit të saj.

Ky miratim vlen vetëm për faturën e identifikuar në këtë formular dhe nuk përbën heqje dorë nga asnjë e drejtë tjetër e shitësit sipas kontratës.

Miratuar nga KESH: Miratuar nga FSHU: